

**SISTEMI ZGJEDHOR GJYSMËPROPORCIONAL: AVANTAZHET,  
DISAVANTAZHET DHE MËSIMET E NXJERRA****ПОЛУПРОПОРЦИОНАЛЕН ИЗБОРЕН СИСТЕМ: ПРЕДНОСТИ,  
НЕДОСТАТОЦИ И НАУЧЕНИ ЛЕКЦИИ****SEMI-PROPORTIONAL ELECTORAL SYSTEM: ADVANTAGES,  
DISADVANTAGES AND LESSONS LEARNED****Abstract**

The electoral system determines the entirety of rules on how to vote and especially how to convert these votes into mandates. The selection of a particular electoral system is of great importance, mainly in democratic representative system, where the electoral system defines who will be the candidates representing its electorate, which will be the winning parties that will constitute the government and the opposite parties.

All electoral systems are considering being democratic however; they can produce various effects in different countries on the country's political system. For each electoral system, are given the advantages and disadvantages, but the question that arises is related to the optimism of the advantages and disadvantages report in order to set the most adequate electoral system. Nevertheless, we can state that the prime aim of the electoral system is to provide and fulfill two main conflicting principles, the representation and the governance.

The purpose of this study is to deal with the semi proportional electoral system, which system of election lays somewhere in between the majority system and the proportional representation system. This system was firstly invented aiming to solve some of the problems of the majority system of election especially regarding the misinterpretations of the political parties and the lack of governing representation from the political and ethnic minorities.

**Keywords:** *semi-proportional system, electoral systems, elections, state, political system.*

---

<sup>1</sup> Asistent profesor në Fakultetin e Shkencave Islame, Shkup. *ORCID ID: 0000-0002-9841-9226* Email: muaz\_agushi@hotmail.com

## Hyrje

Sipas një definicioni, sistemi zgjedhor paraqet bashkim të drejtash, principesh, mekanizmash dhe garancish, mbi bazën e së cilës realizohet pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje. Pra, ato janë të rregulla sipas të cilave votat elektorale përkthehen në ndarjen e posteve apo vendeve në legjislaturë, në mandate politike mes partive apo kandidatëve.<sup>2</sup> Për Sartorin sistemi zgjedhor është “instrumenti më konkret politik për manipulim”. Dhe mu për këtë shpeshherë thuhet se institucioni politik me të cilin mund të manipulohet më lehtë, si për të mirë dhe për të keq, është sistemi zgjedhor.

Pas erës së ndryshimeve të viteve 90, apo siç e quajti Huntingtoni “vala e tretë”, sistemet zgjedhore u shfaqën si mekanizma mjaft të rëndësishëm në konsolidimin e demokracisë përfaqësuese, duke u bërë pjesë e pandashme e jetës dhe agjendës politike. Influencën e sistemeve zgjedhore në konsolidimin e demokracisë përfaqësuese e përshkroi shumë më herët Duverger, duke i cilësuar sistemet zgjedhore në të njëjtën kohë, si variabla të varur dhe variabla të pavarur të sistemit politik. Sipas tij, sistemet zgjedhore janë variabla të pavarur kur ndikojnë në natyrën e partive politike dhe sistemin partiak, sjelljen e politikaneve dhe strategjinë e votës, ndërsa kur sistemet zgjedhore marrin karakterin e variablit të varur, kjo nënkupton se preferencat e politikanëve dhe mendimi i tyre përcakton se çfarë tipi të sistemit zgjedhor kanë përzgjedhur ata.<sup>3</sup>

Në dobi të funksionimit demokratik të shtetit, zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore duhet të japin garanci për arritjen e konsensusit shoqëror dhe ndërtimit të një baraspeshe ndërmjet shoqërisë dhe shtetit. Sistemi zgjedhor duhet të sigurojë kushte për organizimin e zgjedhjeve, ndërsa zgjedhjet janë ata që bëjnë testimin e vullnetit të qytetarëve, duke u dhënë atyre mundësi që në mënyrë të drejtpërdrejt të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në parlament dhe institucionet tjera të shtetit.<sup>4</sup>

Sistemi i zgjedhjeve në çdo vend është i ndërlidhur me karakterin e rregullimit shoqëror e shtetëror të tij. Sa më demokratik të jetë sistemi i zgjedhjeve, aq më demokratik është edhe sistemi, përkatësisht rregullimi shtetëror e shoqëror i atij vendi. Prandaj nuk mund të ekzistojë sistem demokratik i zgjedhjeve në regjimet jodemokratike dhe anasjelltas. Sistemet e zgjedhjeve, të zbatuara në vendet e ndryshme, dallohen njëri nga tjetri. Kriteri kryesor për nga i cili dallohen sistemet e zgjedhjeve është vetë përmbajtja e tyre.

Në teorinë politike dhe shkencën kushtetuese-juridike janë bërë disa klasifikime të sistemeve të zgjedhjeve në bazë të kriterëve përmbajtësore. Dhe

<sup>2</sup> Lawrence C. Mayer; “Politikat Krahasuese, kombet dhe teorinë mbi një botë që ndryshon”, Tiranë, 2003, f. 58;

<sup>3</sup> Oreta Saliaj, “Ndikimi i zgjedhjeve dhe sistemit zgjedhor në demokracizimin e sistemit politik të Republikës së Shqipërisë”, Tiranë, 2014, f. 30;

<sup>4</sup> Etem Aziri, “Sistemi Politik i Republikës së Maqedonisë: formimi, sfidat dhe prespektiva e zhvillimit demokratik”, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2012, f. 27;

mu për këtë, shpeshherë shtrohet pyetja, se cili prej sistemeve zgjedhore është më i miri. Hulumtues të ndryshëm pranojnë se nuk ka sistem të vetëm zgjedhor që i plotëson ambiciet dhe u përgjigjet të gjitha shteteve, pasi sistemet politike dhe proceset zgjedhore u nënshtrohen faktorëve historik, politik, kulturor dhe religjioz.

Llojet e sistemeve zgjedhore variojnë prej atyre të pastra proporcionale kombëtare, ku përqindja e votës kombëtare për një parti përkthehet me përqindje të njëjtë mandatesh në parlament, nëpër ato mazhoritare, ku gara zhvillohet drejtpërdrejt mes kandidatëve në zona të caktuara gjeografike dhe ku fiton kandidati me më shumë vota, e deri te sistemet mikse që kombinojnë elemente të mazhoritarit dhe proporcionalit me specifika të veçanta. Sipas IDEA<sup>5</sup>, trendi botëror po shkon gjithnjë e më shumë drejt sistemeve proporcionale ose drejt forcimit të elementeve proporcionale nëpër sistemet mikse. Në mesin e demokracive më të zhvilluara, vetëm SHBA-të dhe Britania e Madhe kanë sisteme të pastra mazhoritare, ndërsa shtetet e tjera kanë sisteme proporcionale ose të kombinuara.

### **Sistemi gjysmëproporcional apo i kombinuar**

#### *Kuptimi*

Tradicionalisht sistemet zgjedhore janë ndarë në dy kategori më të mëdha, sistemin mazhoritar dhe proporcional. Sistemi gjysmëproporcional apo i kombinuar është njëri prej sistemeve më të mëdha zgjedhore në botë. Është kombinim i sistemit mazhoritar dhe sistemit proporcional, duke përvetësuar anën pozitive të tyre. Ky sistem i zgjedhjeve, votat i shndërron në mandate deputetësh, përmes dy bazave: sistemit mazhoritar dhe sistemit proporcional. Nga sistemi mazhoritar përvetëson parimin e shumicës për të fituar mandate deputetësh për në legjislaturë, ndërsa sistemi proporcional merr metodën e fitimit të mandateve, në proporcion me numrin e votave të hedhura në kutitë e votimit. Sistemi gjysmëproporcional luhatet në mes të sistemit mazhoritar dhe atij proporcional, ku në njërën anë favorizon sistemin mazhoritar me zona të vogla elektorale, p.sh. një kandidatësh apo disa kandidatësh, ndërsa nga ana tjetër sistemin proporcional në zona të mëdha elektorale ose i tërë shteti një njësi elektorale. Sistemi gjysmëproporcional zvogëlon numrin e votave të dështuara, por nuk jep rezultate proporcionale, prandaj për këtë arsye quhet sistem gjysmëproporcional.

Shpeshherë quhet edhe sistem i kombinuar (i përzier), sepse në saje të kombinimit të këtyre sistemeve, partitë politike pas përfundimit të zgjedhjeve

---

<sup>5</sup> International Institute for Democracy and Election Assistance, në portalin zyrtar të organizatës <http://www.idea.int/resources/databases.cfm>, qasur me 7 korrik 2011

mund të fitojnë mandate deputetësh edhe prej listës së votuar sipas sistemit mazhoritar edhe prej listës së votuar sipas sistemit proporcional.<sup>6</sup>

Ka pasur një tendencë në shumicën e vendeve me demokraci të re për të bashkuar dy principe të sistemit zgjedhor, duke formuar lloje të sistemit mazhoritar-proporcional.

Sistemi zgjedhor i kombinuar kontribuon në eliminimin e shumë mangësive që janë hasur në sistemin mazhoritar dhe atë proporcional, duke pasur si qëllim rritjen e përfaqësimit për partitë politike të vogla, si dhe formimin e një mazhorance qeverisëse të qëndrueshme.

Është e vështirë të krijosh një definicion përfundimtar të sistemit të përzier zgjedhor, si shkak i trajtave të ndryshme që formësohen në përbërjen e tij. Por, pothuajse të gjitha sistemet e përziera janë kombinim i zgjedhjes së drejtpërdrejt të ligjvënësve në zonat elektorale të përcaktuara gjeografikisht, formulës zgjedhore, me një formë të sistemit proporcional të përfaqësimit sipas listave partiake.<sup>7</sup>

Sistemi gjysmëproporcional sa vjen dhe po bëhet gjithnjë e më shumë popullor në tërë botën. Pothuajse mbi 30 shtete e përdorin këtë sistem për zgjedhjet në Asambletë parlamentare. Ky përqendrim ka qenë më i madh në vendet post komuniste si: Rusia, Ukraina, Lituania, Armenia, Gjeorgjia, Azerbajxhani, Hungaria, Maqedonia, Shqipëria etj. Sistemi zgjedhor gjysmëproporcional u përdor edhe në Bullgari (1990) dhe Kroaci (1992-1995), para se këto shtete të miratonin ligjet për sistemet proporcionale zgjedhore.<sup>8</sup> Gjithashtu, sistemet e përziera për zgjedhjen e deputetëve praktikohen në Koren e Jugut, Tajvan si dhe në disa vende tjera të Azisë. Edhe Italia dhe Zelanda e Re përdorin këtë sistem por me një shumëllojshmëri të alternativave të hartuara në forma të ndryshme. Për të shpjeguar më qartë funksionimin e sistemit të përzier zgjedhor, do të përmendim rastin e Gjermanisë. Për zgjedhjet në Bundestag, gjysma e anëtarëve të tij (328) zgjidhen në zona një-emërorë, sipas formulës së shumicës së thjeshtë të votave, ndërsa pjesa tjetër e deputetëve zgjidhen nëpërmjet listave të mbyllura partiake në çdo rajon (land). Partitë që nuk arrijnë të kalojnë pragun minimal të caktuar të votave (5%) nuk kanë të drejtë të fitojnë mandate. Numri i përgjithshëm i mandateve që merr një parti politike në Gjermani, është i bazuar në metodën e Niemeyer,

<sup>6</sup> Sadik Haxhiu, "Zgjedhjet, sistemet zgjedhore dhe proceset zgjedhore (Aspekti juridik, politik dhe krahasues)", Prishtinë, 2013, f. 213-2014;

<sup>7</sup> Oreta Salaj, "Ndikimi i zgjedhjeve dhe sistemit zgjedhor në demokrazimin e sistemit politik të Republikës së Shqipërisë", Tiranë, 2014, f. 76;

<sup>8</sup> Sarah Brich, "The Effects of Mixed Electoral System in Eastern Europe", paper prepared for presentation at the 30<sup>th</sup> Annual Conference of the University Association for Contemporary European Studies, Budapest 7-9 April, 2000;

i cili siguron që vendet në Parlament janë në proporcion me votat e dyta të vlefshme, të hedhura për listat partiake.<sup>9</sup>

### **Variantet (llojet) kryesore të sistemit gjysmëproporcional**

Në sistemin zgjedhor gjysmëproporcional hasen dy variante kryesore, edhe atë:

- Vota e vetme e patransferueshme (single non-transferable vote)
- Sistemet paralele

#### ***Vota e vetme e patransferueshme (single non-transferable vote)***

Vota e vetme e patransferueshme, quhet kështu sepse votat e tepërta që mund t'i merr një kandidat në një zonë elektorale shumë kandidatësh nuk mund t'i kalojnë kandidatëve tjerë në garë, të të njëjtës parti politike. p.sh. nëse një kandidat ka fituar 12.000 vota, ndërsa për të fituar mandatin e deputetit duhet të merr së paku 10.000 vota, 2.000 votat e tepërta nuk i shpërndahen kandidatëve tjerë të të njëjtës parti politike në garë por si të tilla dështojnë, përkatësisht humben.

Sipas këtij nënsistemi zgjedhor, secili zgjedhës ka në dispozicion vetëm një votë për të votuar, por zonat zgjedhore janë shumë kandidatësh.

Ky model zgjedhor është zbatuar në Jordani në vitin 1997 për zgjedhjet parlamentare si dhe në Vantau dhe Tajvan, mirëpo zbatimi më i njohur i tij është shënuar në Japoni për zgjedhjen e Dhomës së ulët në periudhën e viteve 1948-1993.<sup>10</sup>

Dallimi më i rëndësishëm në mes këtij modeli dhe modeleve zgjedhore të shumicës konsiston në atë se, ky model jep më tepër mundësi për ta lehtësuar përfaqësimin e partive të vogla politike, në mënyrë që sa më e madhe që të jetë njësia zgjedhore aq më proporcional bëhet ky model.<sup>11</sup>

Marrë në përgjithësi, ky model i nënsistemit zgjedhor ka mjaft mangësi, prandaj edhe nuk ka gjetur ndonjë aplikim të gjerë në botë.

#### ***Përparësitë dhe mangësitë e këtij sistemi***

Ky sistem zgjedhor ka disa përparësi, ku mund të veçohen:

- Mandate deputetësh fitojnë vetëm kandidatët që janë autoritativ
- Krijohet një përbërje mjaft autoritative e përbërjes së legjislaturës, pavarësisht nga përcaktimet politike.

<sup>9</sup> Pipa Norris, "Choosing Electoral System Proportional, Majoritarian and Mixed Systems; for contrasting political institutions, special issues of the International Political Science Review", vol 18 (3), Harvard University July 1997, f. 297-312, edited by Jean Laponce and Bernard Saint - Jacques;

<sup>10</sup> Savo Klimovski & Tanja Karakamisheva, "Politicki partii i interesni grupi", Skopje, f. 252.;

<sup>11</sup> Rainolds, Andrew dhe Relly Ben, "Manual i IDEA (Institute for Democracy and Electoral Assistance) për hartimin e sistemeve elektorale", Prishtinë, 2000, f. 51;

- Kandidatët e të njëjtës parti politike obligohen të bëjnë garë në mes veti me qëllim që të marrin sa më shumë vota nga elektorati i tyre.

Përveç përparësive sistemi në fjalë ka edhe shumë mangësi:

- Si rezultat i shpërndarjes së votave ndërmjet kandidatëve të të njëjtës parti politike, shkakton një numër mjaft të madh të votave të dështuara.

- Kandidatët e të njëjtës parti politike garojnë në mes vete, sikurse në raport me kandidatët e partive tjera, prandaj në plan të parë bie kandidati e jo partia politike dhe programi zgjedhor.

- Nëse partia politike ka fuqi të vogël votuese ndërsa kandidon shumë kandidat, rrezikon të mos e marrë asnjë mandat në legjislaturë.<sup>12</sup>

### *Sistemet paralele*

Njëri prej tipave të sistemit gjysmëproporcional janë edhe sistemet paralele. Ajo që e dallon këtë sistem nga sistemet e tjera zgjedhore është se këtu votuesi ka në dispozicion dy lista përmes të cilave duhet të votojë. Në njërin listë votuesi voton sipas sistemit mazhoritar, ndërsa në listën tjetër votuesi voton sipas sistemit proporcional. Sipas këtij sistemi partitë e vogla që nuk arrijnë suksese sipas sistemit mazhoritar, mund të fitojnë mandate në bazë të listës proporcionale.

Sistemi paralel zgjedhor sa vjen dhe po bëhet gjithnjë e më popullor në të gjithë botën. Pothuajse 30 shtete përdorin sisteme të përziera zgjedhore për zgjedhjet në Asambletë parlamentare. Ky përqendrim ka qenë më i madh në vendet post-komuniste si: Rusia, Ukraina, Lituania, Armenia, Gjeorgjia, Azerbajxhani, Hungaria, Maqedonia, etj. I njëjti sistem, pra sistemi paralel zgjedhor u përdor edhe në Bullgari (1990) dhe Kroacia (1992 dhe 1995) para se këto shtete të miratonin ligjet për sistemet proporcionale zgjedhore.

Rusia në fillim të pluralizmit ka praktikuar një sistem të pastër paralel, sipas të cilit 50% e deputetëve të Dumës shtetërore zgjidheshin sipas sistemit proporcional dhe 50% sipas sistemit të shumicës së thjeshtë. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të Presidentit të Rusisë, Jelcinit, që në zgjedhjet e dyta parlamentare të aprovohej një ligj zgjedhor, në bazë të së cilit 300 deputet do të zgjidheshin sipas sistemit të shumicës së thjeshtë, ndërsa 150 sipas sistemit proporcional, që prej vitit 2007 edhe në Rusi zgjedhjet për Dumën shtetërore zhvillohen sipas sistemit proporcional. Mënyra se si rregullohet baraspeshimi midis numrit të vendeve proporcionale dhe numrit të vendeve mazhoritare dallon shumë nga një shtet në shtetin tjetër.

Është shumë vështirë të formohet një përkufizim përfundimtar i sistemit paralel zgjedhor, si shkak i trajtave të ndryshme që formësohen në përbërjen e tij. Por, pothuajse të gjitha sistemet paralele janë kombinim i zgjedhjes së drejtpërdrejtë të ligjvënësve në zonat elektorale të përcaktuara gjeografikisht,

---

<sup>12</sup> Sadik Haxhiu, "Zgjedhjet, sistemet zgjedhore dhe proceset zgjedhore (Aspekti juridik, politik dhe krahasues)", Prishtinë, 2013, f. 216-2017;

formulës zgjedhore (zonave njëemërore ose votave të patransferueshme), me një formë të sistemit proporcional të përfaqësimit sipas listave partiake).<sup>13</sup>

### ***Përparësitë dhe mangësitë e këtij sistemi***

Ky sistem zgjedhor ka disa përparësi, ku mund të veçohen:

- Partitë politike të cilat nuk mund të fitojnë mandate në zonat elektorale njëkandidatëshe dhe shumëkandidatëshe mund të fitojnë mandate nga lista e proporcionalit.

- Gjinia femërore dhe grupet e vogla etnike më lehtë mund të përfaqësohen në legjislaturë, duke u mbështetur nga lista e proporcionalit.

- Në raport me sistemin mazhoritar, shmang një përqindje relativisht të madhe të votave për të mos dështuar.

Përveç përparësive sistemi në fjalë ka edhe shumë mangësi:

- Zgjedh dy palë deputet të pa barabartë. Ata që zgjidhen nëpër zona zgjedhore dhe i përgjigjen elektoratit dhe deputetët që vijnë nga proporcionali të cilët nuk i përgjigjen fare elektoratit.

- Zgjedhja e deputetëve në legjislaturën e njëjtë bëhet përmes dy formave krejtësisht të kundërta.

- Ky model nuk garanton një përfaqësim të tërësishëm të rezultateve zgjedhore, sepse disa parti politike, mund të mbeten pa mandate edhe pse kanë fituar një numër të konsiderueshëm të votave.

### **Conclusion**

Elections represent one of the mechanisms for collective decision-making based on individual prescriptions within a political system. They are a political response of the electorate to the actions of the leading elite as well as to the organizational form through which citizens participate in the political domain.

The selection of the electoral system is one of the most important institutional decisions for every democracy. However, rarely becomes the selection of an electoral system consciously and deliberately. Oftentimes the selection is accidental, as an unusual result of the combination of the circumstances, a passing trend, or foreign history. If we make a summary of the electoral systems, we will see how difficult is to choose an electoral system since there is no such a perfect electoral system, however we should always try to find one that will produce the most desired results for a specific place.

There is a large number of electoral systems as well as many combination forms between them. Attempting to combine the advantages of majority and proportional electoral systems, during the second half of the XX

<sup>13</sup> Shugart, Matthew, Wattenberg, Martin: "Mixed-Member electoral systems; A definition and typology", Matthew Shugart (Ed), Martin wattenberg (Ed); "Mixed-Member Electoral System: The Best of both Worlds?", Oxford, 2003, f. 9-24;

(twentieth) century electoral experts created new hybrid systems, widely called mixed electoral systems, which are a combination of the majority and proportional electoral systems. This electoral system can be found in the election theory under other names, such as compensatory proportional representative system, personalized proportional representation, and the German electoral system and similar. Germany is the best example, where the members of the Bundestag (parliament) are elected based on the components of the combined system.

This electoral system represents of the three largest electoral systems in the world. The semi-proportional or the combined system ranges between the majority and proportional system, where on the one hand it favors the majority system, with small electoral areas, e.g. of a candidate or several candidates, and on the other hand favors the proportional system with large electoral areas, or the entire state as a single electoral unit. The semi-proportional system reduces the number of the failed votes, but does not give proportional results, which is why is called such. Regardless the terminological differences in name, the essence of the semi-proportional system, is to combine the positive attributes of the majority and proportional electoral systems. The main advantage of the mixed electoral system is its greater flexibility. The voter has the opportunity to vote twice, where the second vote usually corrects the disproportionality of the results from the first votes.

It is defined as a complex and complicated system. It is complex because it uses the advantages of the both electoral systems, since the specific obtained effects in the end and more often can deform its main characteristics, while complexity is not simply from the technical aspect but also from its organizational way.

**Recensentë:**

**Prof. Dr. Etem Aziri**

**Prof. Dr. Elena Andreevska**

**Referencat**

- Andrew Heywood, “Politka”, Prishtinë, 2008;
- Etem Aziri, “Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë: formimi, sfidat dhe prespektiva e zhvillimit demokratik”, UEJL, Tetovë, 2012;
- Lawrence C. Mayer; “Politikat Krahasuese, kombet dhe teoritë mbi një botë që ndryshon”, Tiranë, 2003;
- Oreta Saliaj, “Ndikimi i zgjedhjeve dhe sistemit zgjedhor në demokracizimin e sistemit politik të Republikës së Shqipërisë”, Tiranë, 2014;



- Pipa Norris, “Choosing Electoral System Proportional, Majoritarian and Mixed Systems; for contrasting political institutions, special issues of the International Political Science Review”, vol 18 (3), Harvard University July 1997;
- Rainolds, Andrew dhe Relly Ben, “Manual i IDEA për hartimin e sistemeve elektorale”, Prishtinë, 2000;
- Sadik Haxhiu, “Zgjedhjet, sistemet zgjedhore dhe proceset zgjedhore (Aspekti juridik, politik dhe krahasues)”, Prishtinë, 2013;
- Sarah Brich, “The Effects of Mixed Electoral System in Eastern Europe”, Budapest 7-9 April, 2000;
- Savo Klimovski i Tanja Karakamisheva, “Politicki parti i i intersni grupi”, Skopje;
- Matthew Shugart and Martin Wattenberg “Mixed-Member electoral systems; A definition and typology”, Oxford, 2003;
- International Institute for Democracy and Election Assistance, <http://www.idea.int/resources/databases.cfm>